



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 27-28 dhjetor 2007 janë mbajtur 30 seminare në kuadër të programit të MKLSH anë e mbanë Kosovës. Nga këto seminare:

- 10 kanë qenë për Modulin e pestë “Të nxënit në bashkëpunim” që janë mbajtur në Prishtinë (2 grupe), në Prizren (2 grupe), Gjakovë, Drenas, Shtime, Mitrovicë, Gjilan dhe Klinë,

- 1 ka qenë për modulin e dytë “Zhvillimi kognitiv i fëmijëve” që është mbajtur në Istog, ndërsa

- 19 kanë qenë për modulin e katërt “Teknika për zhvillimin e mendimit kritik” që janë mbajtur në Prishtinë, Hajvali, Podujevë, Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Pejë, Junik, Glllogjan, Malishevë, Krushë e Madhe, Prizren, Suharekë, Dragash, Kaçanik, Ferizaj, Shtime, Viti dhe Gjilan.



Këto seminare janë mbajtur sipas agjendës së përgatitur nga KEC dhe janë zhvilluar në një atmosferë të mirë pune, përkundër faktit që mësime të tilla ishin në pushim. Nga raportet e trajnerëve kuptohet që mësime të tilla tani më e

kanë përvetësuar filozofinë e programit të MKLSH, si dhe zbatimin me sukses të teknikave të mësuara gjatë seminareve të mëparshme. Në trajnim kanë marrë pjesë mbi 900 mësime të tilla të lëndëve të ndryshme. Seminaristët janë njoftuar se gjatë muajit janar dhe shkurt, trajnerët do të bëjnë monitorimin e tyre në klasa.

■ Po ashtu më 11-13 dhjetor në kuadër të MKLSH-së është mbajtur seminari i parë dhe i dytë me përfaqësues të MASHT, KEC dhe disa mësime të tilla të Shkollës Filllore “Zenel Hajdini” në Prishtinë.

Skedat e daljes tregojnë që pjesëmarrësit janë jashtëzakonisht të kënaqur me programin e trajnimit, trajnerët dhe organizimin e punës gjatë ditëve të trajnimit. Disa nga komentet janë: ky trajnim duhet të organizohet për të gjithë mësime të tilla të Kosovës, në trajnim kam mësuar shumë teknika të cilat do të sjellin kureshtje në klasë, edhe pse më herët kam zbatuar disa nga teknikat e mësuara në seminar, unë sot e kuptoj rëndësinë e zbatimit të tyre etj..

Edukimi për të Drejtat e Fëmijës

■ 1 Dhjetori është dita Botërore e Luftës kundër AIDS-it. Andaj, disa nga nxënësit e shkollës jopublike “Mileniumi i Tretë” në bashkëpunim me disa nga mësime të tilla të kësaj shkolle, kanë përgatitur një debat me temën “Si të mbrohemi nga sëmundja HIV-AIDS”. Në këtë debat morën pjesë shumë nxënës të cilët patën rastin të njoftohen me pasojat dhe me mënyrën e parandalimit të kësaj sëmundje.

■ Ashtu si në vitin e kaluar, edhe në këtë vit, nxënësit e shkollës jopublike “Mileniumi i Tretë” kanë treguar

humanitetin e tyre duke ndihmuar dhe gëzuar shumë fëmijë të kryeqytetit. Ata mblodhën mjete dhe blenë dhurata prej më të ndryshmeve. Një grup i nxënësve dhe mësuesve i shpërndanë këto dhurata fëmijëve bonjakë të cilët gjinden në SOS fshatin, në Prishtinë.



Po ashtu, një pjesë e dhuratave u është dërguar fëmijëve të shkollës "Hilmi Rakovica", në Prishtinë.

Edukimi Multikulturor dhe Multietnik

■ Programi u zhvillua sipas dinamikës së projektit. Në muajin dhjetor mbaruan të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të këtij projekti. Një prej aktiviteteve të cilat është zhvilluar këtë muaj, ishte organizimi i një debati me fëmijët me nevoja të veçanta në Gjilan, të cilëve në fund të takimit u shpërndanë dhurata. Tani është duke u punuar në raportin final të këtij projekti. Në bazë të arritjeve të këtij projekti mund të vijmë tek përfundimi se projekti "Edukimi Multikulturor dhe Multietnik" ishte një projekt i cili i kontribuoi dhe do t'i kontribuoi edhe më tutje ndryshimeve të mëdha në fushën e të Drejtave të Fëmijës, bashkëpunimit të fëmijëve nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe një tolerance më të madhe për një jetë të përbashkët. Me fjalë tjera, zbatimi i këtij

projekti ishte një e arritur shumë e madhe në vendosjen e marrëdhënie shumë të mira në mes të fëmijëve të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, në mënyre indirekte i ka kontribuar dhe do ti kontribuoj që në këtë vend të mbretëroj paqja dhe toleranca në mes të gjithëve.

Hap pas Hapi

■ Gjate muajit dhjetor ne kuadër te programit HpH, në Gjakovë u mbajt trajnimi për klasën e dytë. Në këtë trajnim morën pjesë 28 mësime të mësimdhënës. Parashihet që ky grup te vazhdoj me trajnimet tjera gjate vitit te ardhshëm.

■ Një komponentë mjaft e rëndësishme e programit Hap pas Hapi është komponenta e monitorimeve, të cilat duhet të bëhen për të gjithë ata që i ndjekin këto trajnime. Ne muajin dhjetor monitorimet janë intensifikuar, në mënyrë që të zbatohet me përpikëri plani i paraparë i monitorimeve.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Gjatë dhjetorit filloi cikli i parë i trajnimeve për Edukimin për Drejtësinë Shoqërore, Edukimi për Të Drejtat e Fëmijëve dhe Avokim. Sipas planit të hartuar nga përfaqësuesit e KEC, SBASHK dhe KAHCR, shtatë vendet e para për mbajtjen e trajnimeve ishin Lipjani, Deçani, Vushtrria, Kaçaniku, Vitia, Theranda dhe Malisheva. Trajnimet u mbajtën sipas planit të paraparë dhe përkundër kushteve të vështira klimatike pjesëmarrësit treguan interesim për trajnimet.

Edukimi për të drejtën shoqërore

■ Gjatë muajit dhjetor, u përmbyllen të gjitha aktivitetet e këtij projekti.

Është duke u përpiluar Raporti final. Duke u bazuar në vlerësimin e treguesve të këtij projekti konkludohet se janë përbushur të gjitha qëllimet dhe objektivat e këtij programi.

■ Edhe projekti “Edukimi për të Drejtën shoqërore” i financuar nga Banka Botërore, përfundoi më 15 dhjetor '07. Edhe ky projekt u zhvillua ashtu siç ishte e parapare. Muaji dhjetor ka bërë një përmbledhje të të gjitha aktiviteteve të cilat janë zhvilluar në këtë projekt. Këto aktivitete u prezantuan në takimin final i cili ishte i paraparë në këtë projekt.

Ky takim u mbajt me një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve ku prej tyre ishin prind të komunitetit RAE, zyrtarë të Arsimit, trajnerë dhe mësues të cilët ishin pjesë e këtij projekti.



Të gjithë të pranishmit ishin më se të interesuar për mundësinë e vazhdimin të Modullit II të këtij programi.

Është bërë edhe Raporti final i këtij projekti me sugjerimet e nxjerra dhe kërkesat për vazhdimësi të mundshme, dhe ky raport i është dërguar donatorit, respektivisht ‘Bankës Botërore’.

Access Microscholarship Program

■ Projekti në fjalë është duke u zhvilluar sipas dinamikës që ka. Muaji dhjetor është muaji i mbarimit të semestrit të parë për këtë vit shkollor për nxënësit të cilët janë pjesë e këtij projekti. Që nga 20 dhjetori e deri më 25 janar të vitit '08, nxënësit do të kenë pushimin dimëror.

Pasi që ishte fundi i vitit, u organizua një takim përmbyllës (Party) me të gjithë nxënësit e ACCESS-it. Dy grupet nga Prishtina përkatësisht nga Fushë Kosova dhe një grup i Prizrenit, u bënë së bashku atë ditë feste.



Party u organizua në një nga lokalet në Prishtinë, aty ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e Zyrës Amerikane të cilët u ndanë shumë të kënaqur me mbarëvajtjen e këtij projekti si dhe me këtë organizim.

Përgatiti: Petrit Tahiri